

**AKT NORMATIV**  
**Nr. 2, datë 2.3.2022**

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 8952, DATË 10.10.2002,**  
**“PËR LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK TË SHTETASVE SHQIPTARË”, TË**  
**NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas nenit 9/2, të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, të ndryshuar, shtohet neni 9/3, me këtë përmbajtje:

“Neni 9/3  
**Dispozitë kalimtare**

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik të shtetasve, që parashikohen në listat e zgjedhësve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, të shpallura me dekretin nr. 13438, datë 20.1.2022, të Presidentit të Republikës, që përfundon deri në datën 6 mars 2022, zgjatet deri në datën 7 mars 2022.”.

Neni 2  
**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**